



Enver Hoxha - krenaria e kombit shqiptar!

Të nderuar vëllazër,

Jam larg Atdheut kendej detit në Amerikën e largët! Sa me ka marrë malli për Kosovën martire e heroike, që mësimet e Enver Hoxhës na bënin që në shkollë e Universitet (Prishtinë) të duam dhe t'i ruajmë vlerat kombëtare shqiptare. Më mirë që kemi kënduar "Enver Hoxha tungjatë jeta" se sa me i duartrokatur pushtuesit serb të Beogradit...!

Ku po vete sot Shqipëria, Atdheu im i shtrenjët?!

Perdhosje, fyerje edhe të tokës mëmë, të varreve dhe tërë boshtit të vlerave tona shekullore. Nëpër Atdheun tim i veshur me të zeza dhe me kryqin e krimit dhe vrasar ndaj shpirtit të kombit shqiptar, po vjen e po zgërdhiet prifti Jenullatos kinse në emër të Zotit (e kundër Zotit) (sic!!!!) e pushteti aktual i demokracisë po ia puth dorën me dashamirësi e qyqanllëk...!

Kur ishte gjallë Enver Hoxha Atdheu merrte frymë shpirshëm dhe shikonte kah ardhmëria. Lum Atdheu dhe kombi shqiptar që e patëm këtë udhëheqës të madh dhe strateg i kohës shqiptare.

Do ta ruajmë për shumë mote kujtimin për veprën dhe jetën madhore kombëtare të Enver Hoxhës!

Rroftë kombi shqiptar!
Gëzuar Ditëlindjen i shtrenjti Enver Hoxha!

Prof. Skënder Karaçica
Çikago, SHBA